

VENDIM
Nr. 656, datë 31.10.2018

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË
SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË
KËSHILLAVE, BORDEVE OSE
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË
NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bordet, këshillat, komitetet dhe komisionet e përhershme të njësive të qeverisjes qendrore, që këtu e në vijim emërtohen organe kolegjiale, përbëhen nga përfaqësues të njësive të qeverisjes qendrore dhe nga përfaqësues të tjerë, sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës. Përfaqësues i njësisë së qeverisjes qendrore në këto organe emërohet punonjësi organik i njësisë. Punonjësit e emëruar në përbërje të organeve kolegjiale përfitojnë një pagesë për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në këto organe, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Nuk janë objekt i këtij vendimi organet drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve kushtetuese dhe të pavarura, që funksionojnë si të tilla sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, si dhe të institucioneve që nuk financohen nga buxheti i shtetit.

3. Emërtesa e çdo organi kolegjial, numri i anëtarëve në përbërje të tyre, numri maksimal i pagesave në një vit, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera, si dhe masa e pagesës së tyre, përcaktohen në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Masa e shpërblimit të punonjësve të emëruar në komisionet e mëposhtme është, si më poshtë vijon:

a) Për komisionet e posaçme të shpronësimit të ngritura në njësitë publike, masa e shpërblimit të anëtarëve në përbërje të tyre, është 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo vendim shpronësimi të

miratuar;

b) Për komitetin e auditimit të ngritur në njësitë publike, masa e shpërblimit të tre anëtarëve, është 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo mbledhje, por jo më shumë se 4 pagesa në vit;

c) Për Komisionin e Përhershëm të Vlerësimit të Objekteve të Trashëgimisë Kulturore, masa e shpërblimit është 5 000 (pesë mijë) lekë secili prej anëtarëve, për çdo akt vlerësimi;

ç) Për komisionin rajonal mjekësor për caktimin e aftësisë për punë, në varësi të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, masa e shpërblimit është 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj për kryetarin dhe 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj për anëtarin, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera në një muaj;

d) Për Komisionin Epror Mjekësor për Caktimin e Aftësisë për Punë, në varësi të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, masa e shpërblimit është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj për kryetarin dhe 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj për anëtarin, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera në një muaj;

dh) Për Komisionin Mjekësor Qendror për Përcaktimin e Verbërisë, në varësi të Shërbimit Social Shtetëror, masa e shpërblimit është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj për kryetarin dhe 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj për anëtarin, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera në një muaj;

e) Për komisionin e posaçëm për miratimin e materialeve të përkthyer të legjislacionit të Bashkimit Evropian në shqip, pranë ministrisë përgjegjëse për Evropën, masa e shpërblimit të anëtarëve në përbërje të tij përcaktohet sipas kriterëve të udhëzimit të përbashkët të ministrit përgjegjës për Evropën dhe ministrit përgjegjës për financat dhe ekonominë.

5. Kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në senatin akademik dhe bordin e administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.

6. Përjashtohen nga e drejta e pagesës sipas pikës 3, të këtij vendimi, punonjësit e emëruar si përfaqësues të institucionit në më shumë se 2 (dy) nga organet kolegjiale të përcaktuara në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Shpenzimet për kryerjen e pagesës së punonjësve në përbërje të organeve kolegjiale, të cilat vërtetohen kundrejt dokumentit të pjesëmarrjes në mbledhje, si dhe çdo shpenzim

tjetër i natyrës operative (jo shpërblim), të kryer për realizimin e detyrave të organeve kolegjiale, përballohen nga institucionet e ngarkuara për krijimin e organeve kolegjiale, brenda buxhetit vjetor të tyre.

8. Njësia e qeverisjes qendrore që emëron përfaqësues të saj në organet e ndryshme kolegjiale, ka detyrimin e mbajtjes së të dhënave të angazhimit të punonjësve të saj në këto organe.

9. Efektet financiare për organet kolegjiale që rregullohen për herë të parë me këtë vendim, fillojnë nga momenti i funksionimit të tyre dhe përballohen nga buxheti i miratuar për institucionet përkatëse, të përmendura në vendim.

10. Vendimi nr. 418, datë 27.6.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore”, shfuqizohet.

11. Ngarkohen njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

Emertesa e Bordit/Keshilli/Komisionit	Numri maksimal i pagesave ne nje vit	Perberja		Masa e shperblimit ne Leka	
		Kryetari	Nr. i Anetareve	Kryetari	Anetari
Keshilli Rregullimit Teritorit ne RSH	6	1	12	20,000	20,000
Komiteti Kombetar i Digave te Medha	12	1	10	20,000	20,000
Keshilli Teknik i Perhershem i Digave	6	1	4	20,000	20,000
Bordi Menaxhimit te Autoritetit Rrugor Shqiptar				15,000	12,000
Komisioni i dhënies së Licensave Profesionale ne fushen e studimit e projektimit dhe mbikqyrjes e kolaudimit (ne fushen e ndërtimit)	12	1	10	8,000	7,000
Komisioni i dhënies së Licensave Profesionale ne fushen e vleresimit te Pasurive te Paluajtshme	12	1	6	8,000	7,000
Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatoreve	6	1	4	5,000	5,000
Komisioni i Ndhimes Shteterore	6	1	4	10,000	10,000
Bordi i Kontrollit të Brendshem Financiar Publik	4	1	7	20,000	15,000
Komisioni i kualifikimit te auditesve te brendshem	12	1	4	8,000	7,000
Bordi i Mbikqyrjes Publike	12	1	6	20,000	20,000
Keshilli i Larte i Arsimit dhe Shkencës	6	1	18	20,000	15,000
Keshilli Kombetar i Arsimit Parauniversitar	6	1	6		13,000
Komisioni i Larte i Sportit	6	1	5	5,000	5,000
Keshilli Kombetar Kunder Dhunes ne Sport	6	1	8		5,000
Komisioni Antidoping	6	1	9		5,000
Keshilli Kombetar per te Drejten e Autorit	5	1	4	5,000	5,000
Keshilli Shkencor i Bibliotekes Kombetare	4	1	7		5,000
Bordi artistik i Teatrit Kombetar te Opera/Baletit/Asambli popullore	4	1	6	5,000	5,000
Bordi Artistik i Teatrit Kombetar	4	1	6	5,000	5,000
Bordi artistik i Galerise Kombetare	4	1	6	5,000	5,000
Bordi Artistik i Qendres Kombetare per Femije	4	1	6	5,000	5,000
Bordi Artistik i Arkivit Qendror te Filmit	4	1	6	5,000	5,000
Bordi Artistik i Teatrit Kombetar Eksperimental "Kujtim Spahivogli"	4	1	6	5,000	5,000
Bordi Artistik i Cirkut Kombetar	4	1	6	5,000	5,000
Keshilli Kombetar i Arkeologjise	4	1	4		5,000
Komiteti Kombetar i Trashegimise Kulturore Shpiterore	4	1	6		5,000
Keshilli i Akreditimit te institucioneve shendetesore	4	1	5	20,000	15,000
Komisioni i mbrojtjes nga rrezatimi	4	1	7	10,000	10,000
Komitetit Shteteror per Planifikimin Spitalor	4	1	10	5,000	5,000
Komiteti Kombetar i Transfuzionit te Gjaket	2	1	13	5,000	5,000
Bordi i Edukimit te Vazhdueshem ne fushen e sherbimit	8	1	8	7,000	7,000
Komisioni i Çmimit të Bamave	12	1	6	7,000	7,000
Komitetit Ndersektorial per Mbrojtjen nga Produktet e Duhanit (KNMSHPD)	4	1	7	5,000	5,000
Komiteti i Etikës (ne fushen e bamave dhe farmaceutikes)	12	1	9		15,000
Keshilli Drejtues i Komitetit Shqiptar te Biresimeve	12	1	9	10,000	10,000
Komisioni vleresimit te programit mbrojtjes se deshmitareve/bashkepunetoreve te drejtësisë	12	1	4	20,000	15,000
Keshilli i Larte i Arkivave (prane D.P.Arkivave)	4	1	17	10,000	5,000
Komisioni Qendror i Ekspertizes (prane D.P.Arkivave)	4	1	15		5,000
Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvleresimit te Informacionit te Klasifikuar "Sekret shteteror" (prane D.P.Arkivave)	4	1	5		5,000
Komisioni i Perhershem i Ekspertizave te Vleresimit te dokumentave me rendesi historike kombetare (prane D.P.Arkivave)	4	1	9		5,000
Keshilli i Statistikave	6	1	10	20,000	12,000
Komisioni Kombetar i Nomenklatures	3	1	18	10,000	8,000
Keshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës	6	1	17	10,000	10,000
Keshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës	2	1	15		8,000
Bordi i Redaktoreve i Shkollës së Magjistraturës	6	1	9		8,000
Keshilla miratues i projekteve te filmit artistik	3	1	5		20,000
Keshilla miratues i projekteve te filmit dokumentar	3	1	5		15,000
Keshilla miratues i projekteve te filmit vizatimor	3	1	5		15,000
Komisioni i Vizionimit	3	1	2		8,000
Komisioni Financiar i filmit artistik	3	1	3		15,000
Komisioni Financiar i filmit vizatimor	3	1	3		8,000
Komisioni Financiar i filmit dokumentar	3	1	3		8,000
Bordi Drejtues i Keshillit Kombetar Kontabilitetit	12	1	8	20,000	15,000
Bordi Mbiqyrjes i AMSHC	9	1	8	7,000	5,000
Bordi drejtues i Institutit i studimeve per Krimet dhe Pasojat e Komunizmit	9	1	6	20,000	20,000
Keshilli Shkencor i Institutit i studimeve per Krimet dhe Pasojat e Komunizmit	6	1	6	15,000	15,000
Keshilli i Botimeve prane Akademise se Shkencave	3	1	12	5,000	5,000
Keshilli Nder-akademik per Gjuhen Shqipe prane Akademise se Shkencave	3	1	12	5,000	5,000
Keshilli Drejtues i Agjencise se Ofimit te Sherbimeve Publike te Integruara	8	1	6	20,000	20,000
Keshilli Koordinues i Botimeve per Diasporën	6	1	4	5,000	5,000
Keshilli Drejtues i Agjencise Kombetare per Diasporën	6	1	7		15,000
Keshilli Mbikqyrjes i Agjencise Auditimit te Programeve te Asistences	9	1	2	10,000	10,000

